

E hënë dhe e martë në Prishtinë

30 – 31 mars, 1999

Mbrëmë në datën 30 mars, rreth orës 22:00 jam kthyer nga Kosova. Me mua kanë arritur edhe Mentori, Nora dhe vëllai i Norës, Kushtrimi. Gjithçka pat përfunduar mirë falë vozitësit taksist nga Beogradi, i cili në secilin punkt policor ishte plot me llafe dhe pa frikë. Në shenjën e ndalimit ndaleshim, kurse vozitësi pyeste “a thua mund të kalojmë, po shkojmë në Beograd”. Përgjigjja ka qenë, “le t’i shohim emrat” dhe, emri serb i vozitësit, e hapte rrugën. Përndryshe, taksistin e kam takuar për herë të parë të hënën në mëngjes, në datën 29 mars, kur jam nisur për në Prishtinë.

Në Beograd nuk ka benzinë, kështu që kam vendosur për t’u nisur me të vetmin autobus, i cili udhëtonte për në Mitrovicën e Kosovës. Me taksist jam nisur për në stacion të autobusit. Në një moment e kam pyetur taksistin nëse do të më dërgonte deri në Bujanovc, 99 km larg deri në Prishtinë. Më pat thënë se nuk do të më dërgonte, por se ka taksistë, të cilët do të udhëtonin. Me anë të radio stacionit e ka shpallur thirrjen dhe në afat prej pesë minutash ka arritur një taksist, i cili më pat thënë se nuk ka benzinë të mjaftueshëm për kthim, por se shpreson se do të gjejë diku në rrugë. Jemi nisur rreth orës 10:30. Gjatë rrugës jemi ndalur duke i pyetur vozitësit e cisternave të mëdha nëse do të mund të na jepnin e pakta disa litra benzinë. Prej njërit i kemi marrë 10 litra. Kemi arritur deri në Bujanovc dhe aty i kemi gjetur edhe 10 litra. Në ndërkohë taksisti ka pranuar të më dërgojë deri në Prishtinë. Pa problem, por me një habi të madhe në secilin punkt policor, kemi arritur rreth orës 16:00 në Prishtinë. Kemi shkuar deri te zyra jonë, e cila gjendet përtej rrugës së SPB-së dhe burgut. Hyrja ka qenë e mbyllur, kurse banorët nuk kanë dashur të m’i hapin dyert. Në ndërtesën ku gjendet zyra e FDH-së, banojnë shqiptarët dhe serbët. Deri te hyrja ka zbritur një serbe dhe, edhe pse e ka njohur theksin tim serb, nuk ka dashur për ta hapur. Ka thënë “nuk po ju njoh, ka banda të ndryshme dhe nuk do t’ia hapim askujt”. Kam shkuar në pjesën anësore të ndërtesës duke shpresuar se dikush nga banorët do të më njoh dhe do të m’i hap dyert. Askush nuk ka qenë në dritare. Në hyrjen e ndërtesës fqinje e kam parë një grumbull thasësh dhe njerëzit me pushkë. Nga biseda me ta e kam kuptuar se ata janë banorët, shqiptarët dhe serbët, që kishin organizuar ruajtjen e ndërtesës. Njëri prej tyre e ka thirrur Norën me telefon që t’i thotë që të më presë tek këndi i rrugës. Vozitësi ka shkuar në hotelin “Grand”, kurse unë atë natë kam qëndruar tek Nora. Ka ardhur edhe Ariana për gjysmë ore. Në Prishtinë gjithçka përfundonte kur binte errësira.

Heshtja ka mbretëruar edhe para agimit të ditës. Atëherë i kemi dëgjuar detonimet. Jam përpjekur për ta parë Nekibe Kelmendin. Shtëpia ka qenë e mbyllur. Duket se njerëzit, që të strehoheshin, iknin nga shtëpitë e tyre. Duke i kërkuar disa miq, e kam parë se njerëzit po grumbulloheshin para shtëpive, të gatshëm që në grupe të niseshin për në Maqedoni.

Nga Mali i Zi në Prishtinë

3 – 7 prill, 1999

Nga refugjatët shqiptarë në Rozhajë dhe në Ulqin, në veri të Malit të Zi, ende askush nuk është përpjekur për t'u kthyer në Pejë. Atje shkojnë do myslimanë vendor që ta merrnin ushqimin dhe barërat me shqiptarët e tjerë, kryesisht me pleq, ose që t'i merrnin ata për në Mal të Zi. Duke filluar nga e premtja e datës 9 prill, në Rozhajë kanë filluar të arrijnë edhe shqiptarët nga Istogu dhe fshatrat përreth.

Thuajse e tërë Kosova ishte derdhur në Rozhajë. Nuk ka asnjë organizatë ndërkombëtare humanitare. Vijnë gazetarët, e shkruajnë tregimin e tyre nëse është fjala për masakër, dhe kthehen në Podgoricë për ta pritur puçin ushtarak. Në xhami janë mbi 1000 njerëz. Fëmijët, pleqtë, të sëmurët. Nuk janë pastruar qysh kur kanë ardhur në Mal të Zi, në datën 27 ose 28 mars. Djemtë e ri kërkojnë mënyra se si të shkojnë diku jashtë dhe të fitojnë për jetën e tyre. Të gjithë ata do t'i kthenin familjet e tyre në Kosovë, sikur dikush t'ua garantonte sigurinë.

Nga një arsimitare nga Peja e kam kuptuar se njerëzit nga fshati i saj janë dëbuar nga shtëpitë dhe janë dërguar në hallën e sporteve në datën 30 mars ku janë mbajtur rreth 12 orë dhe, pastaj, ushtria i ka kthyer në shtëpi. Të nesërmen prapë janë dëbuar me urdhër për të shkuar në Mal të Zi. Ata, të cilët i kanë dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe i kanë dërguar në hallën e sporteve, i kanë pasur fytyrat e lyera dhe kapelat e zeza në kokë. Thonë se ushtria i ka kthyer në shtëpi duke thënë se "kemi urdhër për t'ju kthyer në shtëpi". Ata, të cilët iu kanë urdhëruar për të shkuar në Mal të Zi, thuhet se kanë qenë në uniforma policore.

Aty, në Rozhajë, dëgjoj se në pjesë të veçanta të Pejës, gjatë dëbimit të njerëzve, ka pasur vrasje. Në lagjen Dardania II (Brzhenik II), në oborrin e familjes Kastrati, janë vrarë pesë meshkuj. Nëna e Nevzatit të vrarë thotë se i biri i saj, vëllezërit Gega, dhe edhe tre meshkuj të tjerë janë masakruar me thika para syve të tyre. Thuhet se në oborrin e tyre kanë hyrë disa meshkuj në uniforma me kapela të zeza në kokë. Asaj i janë dukur se janë të dehur. Kanë bërë titur dhe kanë sharë, asaj i kanë thënë se do ta lënë për të jetuar, sepse është nënë, që duhet të vuajë për djalin e vrarë. Meshkujt, që i kanë gjetur aty, i kanë vrarë me thika. Djali i saj i ka vdekur asaj në duart e saj. I ka rrjedhur gjaku nga plagët e marra. Një nga vëllezërit Gega ka jetuar edhe disa orë, me barkun e shqyer. Të nesërmen kanë ardhur disa të tjerë dhe me kamion i kanë bartur trupat e meshkujve të vrarë.

Në Rozhajë janë habitur kur kam thënë se do të shkojë në Prishtinë. Në dalje, policët më kanë dëshiruar fat. Rruga deri në Prishtinë nëpërmes të Novi Pazarit dhe Mitrovicës së Kosovës ka qenë e zbrazët. Askush, asnjë automobil. Përshtypja ime e parë ka qenë se në Prishtinë nuk ka njerëz. Në Breg të Diellit, te blloku i parë i ndërtesave, pas të cilave fillon fshati Matiçan, ishte shpërngulur. Në parking qëndrojnë automobilat. Në njërin prej atyre ndërtesave, në katin e dytë kanë banuar miqtë e mi. I kam rënë ziles dhe kam trokitur në derën e tyre. E kam kapur në dorë bravën e derës dhe janë hapur dyert. Gjithçka është aty, e pakta ajo që mund të shihet me një shikim. Në atë bllok të ndërtesës i kam takuar vetëm dy gra. Banorëve iu është dhënë dhjetë minuta kohë për të dalë nga banesat dhe të nisen drejt stacionit të trenit. Në bllokun pas këtij kam hasur në fëmijë, të cilët luanin dhe në miq. Këtu nuk shkonte policia. Megjithatë, edhe prej këtu mjaft njerëz kishin shkuar. Nga frika se edhe atyre në çdo moment do t'iu thuhej të lëshonin shtëpitë e tyre. Gjatë të dielës dhe të hënës (në datën 3 dhe 4 prill) disa janë kthyer.

Kanë pritur disa ditë para kufirit dhe pastaj e kanë parë se policia nuk po e pengon kthimin e tyre dhe, së këndejmi, janë kthyer. Pos njerëzve që banonin aty, ka aty edhe njerëz të tjerë nga vendbanimet e tjera.

Serbët dhe shqiptarët mbahen së bashku. Në mbrëmje i mbyllin dyert e hyrjes dhe askush nuk mundet as të dal e as të hyjë brenda. Deri në ndërprerjen e rrymës i dëgjojnë lajmet. Vetëm ndonjë telefon punon. Shqiptarët nuk kanë lidhje me familjen. Nuk e dinë se çfarë po ndodh me të afërmit e tyre në vendet e tjera në Kosovë. Në bisedat e tyre të pandërprera, kthehen në ngjarjet e kaluara, në ato të datës prej 31 marsit deri në datën 3 prill. Disa njerëz nga vendbanimi i Tasligjes krejt rastësisht kanë mbetur në Prishtinë – në momentin e shpërnguljes së tyre nuk kanë qenë në vendbanimin e tyre. Kur ka filluar dëbimi nga vendbanimet e skajshme në Prishtinë ka mbizotëruar paniku. Barteshin thashetheme mbi vrasjet dhe zhdukjet. Askush nuk e merr guximin që zhdukjen e personave t’ia paraqes policisë serbe. Është fakt se shqiptarët më së paku i frikohen bombardimit. Kjo iu duket më pak e tmerrshme se sa “ata”, të cilët do të vijnë e do t’i rrahin. “Ata” janë paramilitarët, policët ose bandat e armatosura.

Duke i dëgjuar lajmet e BBC-së, CNN-it, SKY News-it, TV Tiranës dhe RTV të Serbisë, kanë përshtypjen Prishtina ka kaluar shumë më mirë se sa Peja, Gjakova ose Prizreni. Kafeteritë në qendër janë të shkatërruara para intervenimit të NATO-s. Gjatë sulmeve të NATO-s janë shkatërruar disa objekte të civilëve dhe ka edhe viktima civile. Nga frika se mos akuzohet se po spiunon, askush, e as unë, nuk i afrohet objekteve të shkatërruara.

Gjatë asaj nate të datës 6/7 prill, një kohë të gjatë kam ndenjur dhe kam biseduar me miqtë. D. ka qenë posaçërisht spirituoz. Thotë se gratë janë ato, të cilat i sjellin lajmet mbi ngjarjet lokale, kurse informohen në radhët e pritjes për bukën. Ato e përcaktojnë se kur guxojnë meshkujt për të dalë jashtë ose të shkojnë në vizitë në ndërtesën fqinje. Lajmet shikohen e pastaj përflihen. Temë tjetër është se çfarë thonë serbët, të cilët banojnë në të njëjtën ndërtesë. Edhe pse është fjala për njerëz të zakonshëm, fjalëve të tyre iu kushtohet një rëndësi e madhe. D. thotë se çdo gjysmë ore tek ta fluturon ndonjë “shtëpiake” me informacione të reja nga serbët: »kanë thënë se sot është situata më e mirë« ose »nesër do të jetë pak më mirë «.

Pak pasi qemë shpërndarë, rreth mesnatës, kanë jehuar detonacionet. Janë dëgjuar deri në mëngjes. Në mëngjes nuk ka qenë e mundshme të telefonohet. Në bazë të kësaj, disa njerëz kanë ardhur tek përfundimi se është goditur posta. Vetëm në Beograd e kam marrë vesh se është goditur edhe ndërtesa e sigurimit social dhe se ka viktima civile. Menjëherë para nisjes për në Beograd, kam shkuar për të parë se çfarë po ndodh me zyrën tonë. Nga disa njerëz kam dëgjuar se policia ka hyrë brenda. Para ndërtesës ishte një polic. Më ka lëshuar të hyjë brenda, por më ka thënë se nuk guxoj asgjë për të prekur, sepse »aty është gjetur diçka dhe policia duhet ta hetojë rastin«. Në momentin që kam hyrë në zyrë ka ardhur fluturimthi një plakë serbe me një qen, duke bërëtitur që të »thërras Shërbimin e Sigurimit Shtetëror, sepse i kishin thënë që menjëherë t’i lajmërojë nëse dikush hyn në këtë ambient «. Polici shikonte, heshtte dhe në atë moment unë kam thënë »E po, unë shkova«. Ajo bërtiste pas meje, kurse unë dridhesha nga frika – kam marrë frymë me çlirim kur kam dalë nga Prishtina. Rrugës për në Beograd, në Mitrovicë të Kosovës i kam takuar disa grupe të mëdha të njerëzve. Këmbë me fëmijë kishin dalë për të shkuar në drejtim të Vushtrrisë. I kam pyetur se ku po shkonin. “Në shtëpi, por nuk e dimë a guxojmë”,

më kanë thënë. Ndaj fjalëve të mia “Shkoni në shtëpi” – shumica kanë heshtur, duke ecur tutje«. Iu kam thënë me zë të lartë “Njerëzit po kthehen në Prishtinë, kthehuni në shtëpi”.

Nja dhjetë kilometra nga Mitrovica e Kosovës, nga Rashka, në afërsi të urës, e cila ishte rrënuar gjatë sulmeve të NATO-s, kam mbetur disa orë, duke pritur që të gjej ndonjë transport. Një nga fshatarët ashpër ma ka tërhequr vërejtjen që të mos rri në vendin e tyre. Ai personalisht e kishte parë se para rrënimin të urës nën te po qëndronte një myslimane.

Të dashur miq,

12 maj 1999

Në Mal të Zi bisedoj me avokatë, me refugjatë nga Kosova, se si të organizojmë punën në lidhje me mbledhjen e të dhënave mbi ngjarjet në Kosovë pas 24 marsit. Në Mal të Zi ka mbi 80.000 refugjatë shqiptarë. Rreth 60.000 janë nga Peja, Mitrovica dhe Istogu. Me anë të bisedave do të arrijmë deri te dokumentacioni relevant mbi matricën e spastrimit etnik në vendet e përmendura. Dokumentacioni do t'i shërbejë Prokurorisë së Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë në sjelljen e vendimeve mbi hetimet dhe në ngritjen e aktakuzave. Përndryshe, zyra në Mal të Zi, në Ulqin, është zyra e tretë e Fondit për të Drejtën Humanitare. Zyra e Prishtinës nuk ekziston më. Për herë të fundit e kam parë në datën 3 prill kur, duke e llogaritur nga data 24 mars, kam qenë në Prishtinë për herë të dytë. Përmes dyerve të hapura kam parë dokumentet dhe librat e hedhura, tavolinat pa kompjuterë dhe çrregullim, i cili mbetet pas bastisjes policore. Në afërsi ta zyrës ka banuar Mentor Nimani, një nga juristët e mi. Kurrë nuk do ta harroj datën 29 mars në Prishtinë dhe Mentorin në shkallët e ndërtesës së tij, të shqetësuar nga frika dhe të gatshëm të ikë nga Kosova. Gjatë ditëve paraprake, çdo ditë kemi biseduar me telefon, e kam ditur se është duke jetuar në frikën se dikush do të vij, do të trokas në derë, dhe do ta vrasë, por ajo frikë të cilën e kam parë në sytë e tij më ka shtyrë që në moment të vendos për t'u nisur.

Të punësuarit e tjerë tashmë i kisha gjetur dhe mund të niseshim. Vjollca ka mbetur. Babai i saj ka qenë këmbëngulës që të qëndroj me familjen dhe se nuk guxojnë për ta humbur lidhjen. Pas disa ditësh më është lajmëruar nga Shqipëria. Nga lagjja e saj, të gjithë kanë qenë të shpërngulur, me trena kanë qenë dërguar në Bllacë, 4 fshatra në afërsi me kufirin maqedonas. Aty, në livadhe, në masën prej 20.000 njerëzve i ka kaluar disa ditë. I kanë tubuar natën dhe me autobusë i kanë dërguar në kufi me Shqipërinë.

Atë datë të 29 marsit, nga Prishtina jemi nisur për në Maqedoni. Ariana, Nora, Kushtrimi dhe disa shokë të mi, emrat e të cilëve i ruaj për shkak të sigurisë së tyre. Pas automjeteve tona janë nisur disa qindra automobila. Nga kufiri maqedonas jemi kthyer pas informacionit se ishte mbyllur kufiri me Maqedoninë, por edhe kur i kemi parë policët me maska në fytyrë. Jemi kthyer në Prishtinë, e kemi lënë Arianën, e cila kishte vendosur për të mbetur deri në mbërritjen time të ardhshme dhe jemi nisur për në Beograd. Nuk e di se si kemi mundur për të dalë nga Kosova, me gjasë ka një Zot. Automobili, me tre shqiptar dhe dy serb. I kemi kaluar të gjitha kontrollet, në secilin punkt me frikën se do të na zbulojnë, burgosin dhe ndajnë. Frika e Mentorit nuk është zhdukur në Beograd. Është ndjerë më i lehtësuar, por kjo nuk ka qenë liria.

Pas disa ditëve kemi shkuar në Mal të Zi, kurse Mentori prej atje ka shkuar në Shqipëri e pastaj në Amerikë. Nora ka qëndruar një kohë në Mal të Zi, duke punuar me refugjatë. Në datën 4 maj ka shkuar në Budapest. Edhe ajo do të shkojë në Amerikë. Ariana më ka pritur në Prishtinë. E ka ruajtur xhipin tonë. Në datën pesë maj ka shkuar në Maqedoni. Sot i viziton kampet dhe i interviston refugjatët. Do të kthehet në Kosovë menjëherë sa të jetë e sigurt.

Kurdo që shfaqem në Prishtinë, njerëzit nuk e besojnë se kjo është e mundur. E, edhe vet unë habitem se si ia kam dalë kësaj. Herën e parë në datën 27 mars, jam nisur me taksì nga stacioni i autobusëve në përpjekje për të gjetur farë autobusi për Kosovë. Nja dhjetë metra nga stacioni i autobusëve më ka rënë ndër mend për ta pyetur taksistin nëse do të më dërgonte deri në Bujanovc, vend i cili është 100 km larg Prishtinës, duke menduar se atje do të gjej ndonjë transportues për në Kosovë. Kishte pranuar, kurse kur i ishim afruar Bujanovcit ka pranuar, për një shumë të madhe parash, të më dërgojë deri në Prishtinë. Sikur të mos ishte ai, nuk do t'ia dilja që tre shqiptarë të nxjerrja nga Kosova. Ka ditur të flas me policët, në punkte ka marrë një qëndrim shpërfillës, duke bërë pyetje për benzinën dhe cigaret, duke e lënë përshtypjen se është i tyre. Edhe dy herë kam udhëtuar me te. Para rrugës gjithmonë do të më pyeste se "kë po e nxjerrim tash «.

Kur udhëtoj për në Kosovë, në rrugët pa automobila, me punkte policore dhe ushtarake, që më parë e harroj mundësinë se diçka mund të më ndodh. Derisa vozitem nëpër Serbi më së shumti merrem me shpenzimin e benzinës. Çdo moment e pyes vozitësin se sa kemi shpenzuar. Kur e shohim shenjën e Mitrovicës së Kosovës, filloj të shikoj përreth. Deri në datën 5 maj fshatrat kanë qenë të mbushura.

Shihej se ishin të zbrazëta, por nuk kishte pasur të shtëna. E kam shënuar se në datën 23 prill, në të njëjtën rrugë kam takuar një grup të madh njerëzish, të cilët këmbë shkonin drejt Vushtrrisë. Nga pyjet, ku më shumë se dy javë ishin fshehur, ishin nisur drejt shtëpive, nën frikën nëse policia do t'i lejonte dhe nëse i kanë shtëpitë e tyre. Më kanë shikuar me mosbesim kur iu kam thënë që të kthehen se nga kufiri po kthehen njerëzit edhe në Prishtinë. Fatkeqësisht, po këta, po edhe të tjerë nga Vushtrria, ishin dëbuar nga shtëpitë. Në datën pesë maj e kam parë qytetin e zbrazët dhe shumë shtëpi në flakë duke u djegur. Atë ditë kam kaluar edhe nëpër Mitrovicë.

Në qendër nuk ka pasur as polici e as ushtri. Nuk ka qenë askush. Ishte shkatërruar një pjesë e madhe e qytetit. Shihet se shtëpitë ishin plaçkitur e pastaj ishin djegur. Ka pasur njerëz në vendbanimet e skajshme të qytetit. Fshatrat serbe ishin të paprekura. Më vonë, gjatë bisedave me shqiptarët nga Mitrovica, të cilët kishin ardhur në Mal të Zi, e kam kuptuar se rreth 30.000 shqiptarë ishin dëbuar nga qyteti në datën 15 prill dhe se janë urdhëruar që të shkojnë në Mal të Zi. Kanë shkuar këmbë, iu janë dashur tri ditë për të arritur në fshatin Dubovë, 80 kilometra nga Mitrovica, ku i ka ndalur ushtria e Jugosllavisë. Aty janë mbajtur tri ditë e, pastaj, tre oficerë kanë thënë se »është sjellë urdhëresa që të kthehen nëpër shtëpi«, i kanë futur nëpër autobusë dhe i kanë kthyer në Mitrovicën e djegur. Uria dhe frika, shumë prej tyre, i ka shtyrë që të dalin nga Mitrovica dhe të kalojnë në Mal të Zi.

Sa herë që hyj në Prishtinë, marrë frymë më lehtë. I them vetes se »aty është«. Nuk është më Bajram Kelmendi. Është vlarë gjatë natës së parë të bombardimeve. Atë natë është nxjerrë nga shtëpia e tij me të dy djemtë. Nuk është më as Fehmi Agani. Asnjëherë nuk e kam parë më në Prishtinë. Herën e fundit

është parë në varrim të Bajram Kelmendit në datën 27 mars. Njerëzit flisnin se është në Prishtinë, se është duke u fshehur duke i ndërruar shtëpitë dhe se është mirë që nuk po shfaqet dhe nuk po del në rrugë. Jam përpjekur për ta gjetur, por askush nuk e dinte se ku ndodhej. Sot e pyes veten se a është e mundur që ka qenë në liri dhe që vet të përcaktohet të mos komunikojë me asnjë njeri. Nuk do të qetësohem deri sa nuk do ta kuptoj se si është vrarë dhe çfarë ka ndodhur me te pas varrimit të Kelmendit. Ka qenë një mik i imi shumëvjeçar. Edhe tash i dëgjoj fjalët e tij duke thënë »si është Natasha, a ka punë më pak, si është me shëndet, familja«, dhe, në të njëjtën frymë, duke thënë »ka shpresë, duhet të besojmë se do të bëhet më mirë«. Në vitin e largët 1994, kemi qenë së bashku në konferencën mbi Tribunalin e Hagës në Bern. I mbaj në mend ato ditë për dy arsye. Edhe pse ishin vetëm disa pjesëmarrës nga Serbia, ai, para një publiku të madh, në të cilin shumica ishin shqiptarë, ka folur në gjuhën serbe. Ka thënë se këtë po e bënë për shkak të miqve të tij serb dhe për shkak të respektit për punën e tyre. Në njërën prej atyre ditëve më ka ftuar të takohem me ish studentët e tij, të cilët kishin udhëtuar nga Gjermania dhe Zvicra që të përcjellin një pjesë të konferencës mbi Kosovën. Kur më ka prezantuar, ka qenë e qartë për mua se paraprakisht nuk iu kushte thënë se e kishte ftuar një serbe. Kjo ka qenë në kohën kur rrallë ka ndodhur që intelektualët serbë dhe shqiptarë të ulen së bashku dhe të bisedojnë. E kam parë habinë në fytyrat e studentëve të tij, ka pasuar mirëseardhje dhe kërkim falje që gjuha e tyre serbe nuk ishte e mirë.

Lajmi mbi vdekjen e tij më ka gjetur në Mal të Zi. Në recepcionin e një hoteli në Ulqin më kanë thënë se një kushërirë e Aganit nga Prishtina ka lajmëruar se Fehmiu është burgosur. Të nesërmen ka arritur lajmi se trupi i tij është gjetur në Lipjan.

Përshëndetje, Natasha

Të dashur miq,

Ndodhem në Beograd. Do të jem disa ditë, kurse pastaj do të shkojë në Kosovë dhe në Mal të Zi. Kam marrë një letër nga Prizreni. Është e shkruar në datën 4 maj, kurse ka arritur në datën 20 maj. E mban vulën e postës së Serbisë. Sigurisht se e ka dërguar dikush, i cili ka dalë nga Prizreni. Letra është shkruar me letra të shtypit, pa nënshkrim, por është nga një mik imi i mirë. B. thotë se drejt kalimit të kufirit në Vrbnicë çdo ditë lëvizin kolona të mëdha të refugjatëve. Deri te kufiri me Shqipërinë ka tri punkte të kontrollit. Kam dëgjuar se shumë prej refugjatëve ua kanë shqyer dokumentet personale, kurse nga automobilat ua kanë hequr tabelat e regjistrimit. Shqiptarët e tjerë nuk dalin nga shtëpitë. Pas dëbimit masiv të shqiptarëve nga fshatrat përreth dhe vet qyteti, në shënjestër janë vënë mjekët, profesorët, avokatët, veprimtarët e partive politike dhe shqiptarët, të cilët kanë punuar për OSBE-në ose të punësuarve në atë organizatë, që ua kanë dhënë shtëpitë me qira. Dërgohen në biseda informative e, pas kësaj, përndiqen në Shqipëri. B. thotë se disa prej personave të dëbuar janë lajmëruar përmes mjeteve publike të informimit, por se disave prej tyre iu ka humbur çdo gjurmë. Rreth 650 familje shqiptare nuk e din se çfarë ka ndodhur me djemtë e tyre, të cilët dhunshëm janë mobilizuar në ushtrinë jugosllave. Nga autoritetet ushtarake lokale e kemi marrë informacionin se fëmijët e tyre janë në pozicione afër kufirit shqiptar dhe se hapin llogore. Të gjithë janë në frikë në shkallë paniku nga grupet

paramilitare, nga automjetet pa tabela, nga marrja në dëgjim dhe nga dëbimi i mundshëm, kurse në kohët e fundit edhe nga uria. Të sëmuret nuk guxojnë të shkojnë te mjeku. I janë kthyer barërave popullore. Në radhët e pritjes për bukë flitet se shqiptarët e mbetur do të duhej të përcaktoheshin se a janë qytetarë lojal, në të kundërtën, si armiq, do të detyrohen të lëshojnë Kosovën. B. thotë se ky fakt po ua nxjerrë mendtë. Nuk e dinë se çfarë të bëjnë. Nëse shkojnë, i humbin shtëpitë, pronën dhe qytetin të cilin duan, kurse nëse mbesin i pret përulja. Sikur të kishte farë organizatash ndërkombëtare do të ndjeheshim më sigurt, do të qëndronim dhe do të mbeteshim. Aq shumë është futur frika brenda njerëzve sa që e fshehin edhe na njëri-tjetri se do të largohen nga qyteti. Sot ka edhe disa lajme të mira. Kur është fjala për Kosovën, lajm i mirë është kur në Kosovë më thonë se “ka qenë policia, ka qenë mirë, askënd nuk e kanë vrarë”. Në datën 21 maj, në vendbanimin e Bregu i Diellit në Prishtinë, policia i ka kontrolluar rreth 200 banesa të shqiptarëve. Ua kanë kontrolluar dokumentet personale, kanë pyetur për armë dhe i kanë evidentuar refugjatët. Miqtë e mi thonë “nuk na kanë rrahur dhe ngucur”. Policia i ka ndarë rreth 60 të rinj, në mesin e të cilëve edhe disa vajza. Pos disa vajzave të shkollës së mesme, të gjithë të tjerët janë studentë. Pas bastisjes, disa janë lëshuar menjëherë, kurse 18 prej tyre janë dërguar në polic.

Pas marrjes shumë-orëshe në pyetje, 14 të rinj janë lëshuar, kurse dy vajza dhe dy djem janë mbajtur. Këta të katërt janë marrë nga banesa, në të cilën policia e ka gjetur një uniformë të armatës së ish - Jugosllavisë. Në atë vendbanim flitet se një fqinj serb do të shkojë për të pyetur se si është puna me ta.

Aktivitetet intensive diplomatike në lidhje me Kosovën më kanë trimëruar për të dërguar disa shkrime të mia nga Kosova në gazetën ditore beogradase “Danas”. Redaktori më ka thënë se tekstet janë të shkëlqyeshme dhe se flasin mbi gjërat, për të cilat nuk dihet në Beograd, por nuk guxon për t’i botuar. Sot kam kaluar pranë disa objekteve, të cilat janë shkatërruar nga sulmet e NATO-s. Kam kërkuar nga autoritetet ushtarake që t’i lejojnë Fondit për të Drejtën Humanitare qasjen ndaj objekteve civile dhe dëshmitarëve të sulmeve ndaj civilëve – kanë refuzuar me fjalë fyese. Kështu, po e krijojmë dokumentacionin në bazë të raporteve gazetareske. Kur udhëtoj nëpër Serbi, kurse koha po kalon, gjatë rrugëve të fshatrave, bisedoj me njerëzit dhe e shoh se për ta gjithçka është e qartë dhe se e kuptojnë se çështja e përgjegjësisë për gjithë atë që po ndodh është më e rëndësishmja për çështjen serbe. Por, të gjithë e thonë këtë, kjo çështje në këtë moment nuk mund të shtrohet.

Nga data 24 mars e deri më sot më shumë se 50.000 njerëz kanë shkuar nga Beogradi. Nuk është e lehtë të përshkruhet se si jetohej në Beograd. Kur disa miqve të mi të jashtëm iu kam thënë se në rrugë ka njerëz si edhe më parë, se njerëzit rrinë në kafeteri edhe kur dëgjohej sirena, se ka taksitë edhe në mbrëmje, kur rrugët mbesin në errësirë, dhe se nuk e njoh askënd i cili rri në strehimore, ata kanë qenë të habitur dhe dyshojnë nëse është pikërisht ashtu. Megjithatë, qëkur nuk ka rrymë elektrike dhe ujë, pos radhëve të pritjes për bukë, shihet se njerëzit dalin edhe për furnizimin për ujë. Të gjithë tashmë e dinë se qirinjtë janë më të lirët në kishë dhe se qëndrojnë më gjatë se sa qirinjtë dekorativ.

Deri në datën 24 mars, në Beograd kanë qenë rreth 100 studentë shqiptarë. Sot janë gjithsejtë vetëm disa prej tyre. Në datën 13 maj, policia ka hyrë në banesën e tyre në rrugën Klara Cetkin, numër 5, në Beogradin e Ri, dhe pas bastisjes i ka marrë katër studentë: Edona Hajrullahu, Bekim dhe Safet Blakaj, dhe Luigj Nduen. Luigji banon në këtë banesë tash e gjashtë vite. Ka qenë pikërisht para mbrojtjes së

temës së magistraturës në Katedrën e Defektologjisë. Kur ka filluar bombardimi, tek ai, nga konvikti i studentëve, kanë kaluar Edona, Bekimi dhe Safeti. Fqinja, e cila i ka parë kur policia i ka marrë të rinjtë, thotë se me atë rast është marrë edhe një vajzë me flokë të shkurta. Me anë të verifikimit, në gjykata e është vërtetuar se kundër personave të arrestuar nuk ka padi penale. Në këtë moment policia nuk jep kurrfarë informacione.

Në Serbi, me të madhe i jepet përkrahje përfundimit të luftës me anë të plotësimit të kushteve të Grupit të tetë vendeve më të zhvilluara. Kjo shihet nga deklaratimet e funksionarëve të lartë partiak të partisë në pushtet dhe funksionarëve shtetëror. Është shpeshtuar përmendja e refugjatëve shqiptarë si rezultat i drejtpërdrejtë i bombardimeve të NATO-s. Pos politikanëve, këtë mendim e thonë edhe ekspertët e ligjit. Në bisedë me University of Pittsburgh School of Law (JURIST: The Law Professors' Network), në pyetjen nëse forcat e armatosura jugosllave janë përgjigjur ndaj sulmeve të NATO-s me "deportation and forcible transfer of Albanian population" (deportimin dhe bartjen e dhunshme të popullatës shqiptare), profesori beogradas i Fakultetit Juridik thotë se shqiptarët ikin nga bombat e NATO-s. Fakulteti i përmendur pohon se në Beograd çdo ditë arrijnë trenat me shqiptarë, serb, turq dhe të tjerë të cilët ikin nga Kosova. Me qëllim të shqiptimit të së vërtetës, me këtë rast po e citoj një pjesë të dëshmisë së një shqiptari nga Peja, krahas shënimit se kam biseduar me 98 shqiptarë të dëbuar nga i njëjti qytet dhe se të gjithë ata në mënyrë të pavarur e kanë pohuar dëshminë e tij mbi mënyrën e dëbimit të shqiptarëve nga qyteti:

"E premtë, 26 mars. Kemi qenë në tavolinë, kur në shtëpi kanë hyrë njëzetë persona të uniformuar me bereta të kuqe dhe tre civil. Askush prej tyre nuk ka pasur maskë në fytyrë. Uniforma e tyre ka qenë e ngjashme me atë të ushtrisë. I kam njohur disa prej tyre, të cilët kanë banuar në Dardani I ("Brzhenik I"). Me të hyrë në shtëpi, kanë bërë: "menjëherë, për një minutë duhet të dilni prej shtëpisë". Nusja ime është nisur për ta vënë fëmijën në djep dhe e ka vënë aty kur një nga personat e uniformuar e ka goditur me këmbë djepin – djepi me fëmijën kanë rënë dhe fëmija ka filluar të klith. Jemi nisur të gjithë për të dalë nga shtëpia, pos babait të mplakur, i cili është i palëvizshëm. Njëri i ka urdhëruar djalin tim, Blerimit, të qëndrojë. Djali ka heshtur, kurse unë dhe gruaja kemi filluar të qajmë dhe që në vend të tij të qëndrojmë ne. Atëherë djali ka filluar të bërtas duke thënë se vetëm ai do të mbetet dhe që sa më parë ta lëshojmë dhomën. Unë dhe gruaja nuk kemi dashur të dalim, ata na kanë kapur për krahësh dhe na kanë tërhequr jashtë. E kam parë pushkën në tëmthin e Blerimit, jam kthyer vrik për t'i ndihmuar dhe e kam dëgjuar një të shtënë dhe e kam parë se si Blerimi kishte kërcyer lart dhe kishte rënë para këmbëve të babait të tij plak. Më kanë zënë, por ka vrapuar gruaja dhe më ka nxjerrë nga dhoma. Kur kemi dalë nga dhoma, kanë shtënë edhe tri herë. Kam dëgjuar se si, duke bërë, na thoshin të shkojmë tek Klintoni. Trupi i Blerimit ka mbetur. Jemi përpjekur për të shkuar tek të afërmit tanë. Në rrugë kanë qenë kolonat e njerëzve. Policia na ka thënë të hyjmë në kolonë. Na kanë thënë se rruga për në Mal të Zi është e lirë".

Përsëritje, Natasha